

#23 ... 



Advocacy Center
for **Democratic Culture**



NËNTOR

2022

BULETINI



office@acdc-kosovo.org
ngoacdc@gmail.com



Cika Jovina 3, North Mitrovica
Prote Mateje 48, Belgrade
Fehmi Agani 168/5, Prishtina





LANSIMI I NGJARJES

Më 9 nëntor 2022, OJQ ACDC organizoi ngjarjen për të prezantuar vazhdimin e projektit "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe të Kosovës", të zbatuar nga OJQ ACDC në bashkëpunim me OJQ AKTIV dhe financuar nga INL.



Gjatë aktivitetit, OJQ ACDC dhe OJQ Aktiv prezantuan aktivitetet e projektit që janë arritur dhe janë realizuar gjatë vitit të kaluar dhe hapat e ardhshëm të planifikuar për periudhën e ardhshme të zbatimit 2022-2023.



Projekti është i ndarë në dy komponentë:

- 1) Kundër korrupsionit dhe pjesëmarrja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse në komunat me shumicë serbe të Kosovës, dhe
- 2) mbështetje për administrimin e drejtësisë në zonat me shumicë serbe të Kosovës.



FORUMI PËR DIALOGUN E IAPK DHE OSHC-VE

Më 16 nëntor, në Prishtinë është mbajtur takimi i punës i Forumit për Dialog të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës (IAPK) dhe Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC).



Në takim u prezantuan iniciativat e zbatuara pas takimit paraprak të Forumit, si dhe konkluzionet e Avokatit të Popullit lidhur me të gjeturat e Raportit të Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë për vitin 2021.

Në kuadër të projektit “Grate për grate të bashkuara në veprim” ne vazhduam organizimin e takimeve me anëtarët e rrjetit të Grave me qëllim të bashkimit të grave nga institucione të ndryshme të veriut të Kosovës, për të shkëmbyer përvoja dhe për të rritur lidhjet e tyre.



TAKIMET ERRJETIT TË GRAVE



Programi i trajnimit të vazhdueshëm për gjuhën shqipe ndihmon stafin e ACDC-së të zhvillojë njohuritë dhe aftësitë e tyre në gjuhën shqipe. Programi është pjesë e Grantit për Zhvillim Organizativ, i mbështetur nga programi i KCSF-së, “EJA Kosovë”.

M4Y

Zbatimi i projekteve të realizuara nga të rinjtë nga Zveçani, Vushtrria, Skenderaj dhe Ranillugu, të cilët kanë marrë grante në kuadër të projektit M4Y ka vazhduar edhe këtë muaj.






Menaxheri i programit, Slobodan Stosic mori pjesë në seminarin "#OCDzajezičkaprava" të organizuar nga OJQ CSD. Ngjarja mbledhi së bashku përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që merren aktivisht me të drejtat gjuhësore në Kosovë për të përcaktuar së bashku hapat e veprimit në të ardhmen dhe për të mbështetur rolin, aktivitetet dhe veprimet të përcaktuara qartë të Zyrës së Komisionerit për Gjuhët.



Biseda MEDIALE

Zëvendësja e Avokatit të Popullit të Kosovës, Marija Radulović, prezantoi punën dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në promovimin dhe avancimin e të drejtave të njeriut. Biseda për media është pjesë e një fushate publike të zbatuar nga OJQ ACDC, e cila synon të promovojë Institucionin e Ombudspersonit të Kosovës dhe të rrisë dukshmërinë e institucionit në rajonin e Mitrovicës.

Video




Menaxheri i programit në ACDC Slobodan Stosiq dhe zyrtarja e programit, Ines Aljović Mihajlović, prezantuan vazhdimin e projektit "Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe të Kosovës", si dhe folën për aktivitetet që janë realizuar në vitin paraprak.

Video



Biseda e tretë mediale foli Aleksandar Rapajić, në kuadër të fushatës publike që synon fuqizimin e grave nga komunitetet joshumicë, për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse dhe për të rritur ndërgjegjësimin e burrave për rëndësinë e përfshirjes së tyre. Ndiçni se çfarë thotë Aleksandri për pozitën e gruas në veri të Kosovës.

Video





Në fillim të nëntorit, mosmarrëveshja për targat e lëshuara nga Serbia inicuan dorëheqje masive të serbëve nga institucionet e Kosovës dhe shkaktuan një krizë të madhe politike në veri të Kosovës.



Gjatë këtij muaji, drejtori ekzekutiv i ACDC-së Dushan Radaković dhe përfaqësues të tjerë të OSHC-ve nga Mitrovica e Veriut janë takuar me shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomáš Szunyog, për të diskutuar situatën politike aktuale në veri të Kosovës.



Lexoni se çfarë tha për mediat drejtori ynë ekzekutiv dhe programor për krizën politike në veri të Kosovës:

Dushan Radaković foli për Kosova Online për refuzimin e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës – Drejtorisë Rajonale Veriore për të zbatuar vendimin e Prishtinës për paralajmërimin për vozitësit që nuk posedojnë targa RKS.



Aleksandar Rapajiq për "RTS" foli për zgjedhjet lokale në veri të Kosovës të shpallura nga presidenti i Kosovës, të planifikuara të mbahen muajin e ardhshëm!



Aleksandar Rapajiq për "Danas" foli për situatën në veri të Kosovës pas tërheqjes së serbëve nga institucionet e Kosovës!



Së bashku me OSHC-të tjera nga Kosova dhe Serbia, ne shprehëm mbështetjen tonë për drejtorin e OJQ Aktiv, Miodrag Milicević, i cili u sulmua verbalisht dhe fizikisht nga një pjesëtar i njësisë speciale të Policisë së Kosovës afër Jarinjës në veri të Kosovës.

Lexoni deklaratat në gjuhën serbe, angleze dhe shqipe.

SRB

ALB

ENG